

MONITORIMI I SHPENZIMEVE TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR VITIN 2013

Në zbatim të kreut VI, pikës 256 të udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012, të Ministrisë së Financave, "Për Procedurat Standarde për Zbatimin e Buxhetit ", të Ministrisë së Mbrojtjes, gjatë 12-mujorit të vitit 2013 ka planifikuar të administrojë dhe menaxhojë fondet buxhetore, sipas shtatë programeve të miratuara për Sistemin e Mbrojtjes dhe konkretisht:

1. Planifikim, Menaxhim dhe Administrim.
2. Forcat e Luftimit
3. Arsimi Ushtarak
4. Mbështetja Shëndetësore
5. Mbështetja e Luftimit
6. Mbështetja Sociale për Ushtarakët
7. Bashkëpunimi Civilo - Ushtarak

Buxheti vjetor, i rishikuar për këto shtatë programe, për vitin 2013 është realizuar në masën 99.3% siç duket edhe nga tabela e mëposhtme.


Tab. 1, Fondet buxhetore sipas programeve buxhetore të miratuar për vitin 2013; 12 - mujori (buxheti 2013 në mijë lekë).

në mijë lekë							
MINISTRIA MBROJTJES				Kodi i Grupit		17	
SHPENZIMET E MINISTRISË - VITI 2013							
			(1)	(2)	(3)	(4)	(5)=(2)-(4)
Programet			PBA	Buxheti	Buxheti i	Fakti	Diferenca
Titulli	Emri i Programit		Plan 2013	2013	Rishikuar 2013	2013	2013
O1110	Planifikim, Menaxhimi dhe Administrimi		1,243,800	1,243,800	1,243,106	1,242,933	867
O2120	Forcat e Luftimit		7,629,630	7,629,630	7,600,401	7,529,141	100,489
O9430	Arsimim Ushtarak		928,600	928,600	862,222	843,696	84,904
O7340	Mbështetja Shëndetësore		89,250	89,250	89,250	85,003	4,247
O2150	Mbështetja e Luftimit		4,251,230	4,251,230	4,229,259	4,207,986	43,244
10270	Mbështetje sociale për ushtarakët		4,550,000	4,550,000	4,550,000	4,550,000	0
O2280	Bashkëpunimi Civil-Ushtarak (AL-CIMIC)		583,640	583,640	574,914	563,101	20,539
TOTALI			19,276,150	19,276,150	19,149,152	19,021,860	254,290

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, për çdo program, sipas PBA-së, buxhetit fillestar të 2013 dhe realizimit faktik për 12-mujorin e vitit 2013, jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm (në %):

Nr.	Emërtimi	VITI 2013			
		PBA	Buxh (Ligji)	Plani me Ndryshimet	Fakti
1	Planifikim, menaxhim, administrimi	6.5	6.5	6.5	6.5
2	Forcat e luftimit	39.6	39.6	39.7	39.6
3	arsimi ushtarak	4.8	4.8	4.5	4.4
4	Mbështetja shëndetësore	0.5	0.5	0.5	0.4
5	Mbështetja e luftimit	22.1	22.1	22.1	22.1
7	Mbështetja soc ushtarakët	23.6	23.6	23.8	23.9
8	Bashkëpunimi civil-ushtarak	3.0	3.0	3.0	3.0
	TOTALI	100.0	100.0	100.0	100.0

Shpenzimet e Buxhetit Faktik (në %):



Pesha specifike e çdo programi për vitin 2013 është: 39.6% shpenzimet për programin "Forcat e luftimit"; 22.1% shpenzimet për programin "Mbështetja e Luftimit"; 6.5% "Planifikimi Menaxhimi, Administrimi", 4.4% "Arsimimi Ushtarak", 3% programi "Bashkëpunimi Civil Ushtarak", 0.4% programi "Mbështetja Shëndetësore" dhe 23.9% shpenzimet për programin "Mbështetje sociale për ushtarakët",

Sipas grupeve kryesore të shpenzimeve përqindja e realizimit ndaj buxhetit vjetor është:

- Shpenzime personeli 99.2%
- Shpenzime të tjera korrente 99%.

Nga këto:

- Mallra dhe shërbime 100%
- Korente te tjera 99%
- Shpenzime për mbështetjen sociale të ushtarakëve (ISSH) 100%.
- Investime me financim nga buxheti shtetit 100%.

MONITORIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

1. Programi "Planifikim, Menaxhim, Administrim".

Shpenzimet faktike për vitin 2013 në këtë program, që përfaqëson rreth 6.8% të totalit shpenzimeve të Ministrisë, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor, sipas ligjit të buxhetit, rezultojnë si më poshtë:

- Shpenzimet korrente 100%
- Shpenzimet kapitale 99,6%
- **Gjithsej 100%**

Për vitin 2013, u parashikuan 3 produkte, në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuar si më poshtë:\

						në mijë lekë
MINISTRIA MBROJTJES						Kodi: 17
						Titulli: O1110
Programi: Planifikim, Menaxhimi dhe Administrimi			VITI 2013			
Kodi i Prod.	Emri i Produktit	Ins.Buxh.	(1) Buxheti Rishikuar	(2) Fakti	Mbetja (1-2)	% Realizimit
1	Personel i Aparatit të MM dhe Shtabit të Përgjithshëm	DASH	1,038,106	1,011,367	26,739	97
2	Pajisje hardware, software për automatizimin e sistemit sigurisë MM	DASH	20,000	19,929	71	100
3	Marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara	DASH	185,000	184,989	11	100
TOTALI			1,243,106	1,242,933	26,821	100

Në programin "Planifikim, Menaxhim, Administrim", shpenzime personeli, shpenzime korrente, produktet janë realizuar në 100%.

- Personel i Aparatit të MM dhe Shtabit të Përgjithshëm realizuar në masën 100% për vitin buxhetor 2013.
- Në artikullin 606 deri më 31.12.2013 realizimi në masën 100%.
- Marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara janë realizuar në masën 100%.
- Produktet janë në proces realizimi sipas nevojave dhe parashikimeve të bëra në raportimin e treguesve të buxhetit sipas periudhave.

2. Programi “Forcat e luftimit”.

Shpenzimet faktike për 12 - mujin e vitit 2013 në këtë program, që përfaqëson rreth 38.2% të totalit të shpenzimeve të Ministrisë, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor, sipas ligjit të buxhetit, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korrente 98.5%
- Shpenzimet kapitale 100%
- **Gjithsej 99.1%**

Për vitin 2013, në këtë program u parashikuan 7 produkte, të cilat rezultojnë të plotësuar si më poshtë:

MINISTRIA MBROJTJES			Kodi: 17			
Programi: Forcat e Luftimit			Titulli: O2120			
Kodi i Prod.	Emri i Produktit	Ins.Buxh.	VITI 2013			
			(3) Buxheti i Rishikuar	(4) Fakti	Mbetja (1-2)	% Reali zimit
1	Personel në Komandën e Forcës Tokësore (1001 Tr,1010Shk, 1030 Tiranë)	Rep.Usht.Nr.1100-1001 Tiranë - BrRSh.	3,721,679	3,660,293	61,386	98
3	Personel në Komandën Forca Ajrore	Rep.Usht.Nr.3001,3005, 3006.	815,546	809,110	6,436	99
4	Bashkëshortë ushtarakësh që përfitojnë pagesë papunësie		34,970	31,978	2,992	91
5	Pajisje fushore të blera BrRSH	Rep. Usht. Nr.1001	17,000	16,556	444	97
6	TVSH dhe taksë doganore për projektin e helikopterëve	Rep. Usht. Nr.3001	1,237,205	1,237,204	1	100
7	Blerje Helikopter Transporti shumërolësh	Rep. Usht. Nr.3001	1,774,000	1,774,000	-	100
TOTALI			7,600,400	7,529,141	439,963	99

Siç shihet nga tabela e mësipërme, shpenzime personeli, shpenzime korrente, produktet janë realizuar në masën 99%.

- Shpenzimet për personelin janë realizuar në masën 99%.
- Realizimi i detyrimeve për 12 - mujin për bashkëshortet e ushtarakëve që përfitojnë pagesë papunësie është në masën 91%.
- Në artikullin 231 investimi në nivel programi, “Pajisje fushore të blera BrRSH”, Reparti Ushtarak Nr.1001 është realizuar në masën 100%.

Për Repartin Ushtarak Nr.3001 projektet si më poshtë:

- Projekti Blerje Helikopter Transporti shumërolësh është realizuar në masën 100%.
- Për sa i përket pagesës së TVSH dhe taksës doganore për projektin e helikopterëve themi se përqindja e realizimit arrin në masën 100%.

3. Programi “Arsimimi Ushtarak”

Shpenzimet faktike për vitin 2013 në këtë program, që përfaqëson rreth 4.4 % të totalit shpenzimeve faktike të Ministrisë, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor, sipas ligjit të buxhetit, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korrente 98.4%
- Shpenzimet kapitale 92.9%
- **Gjithsej 97.9%**

Për vitin 2013, u parashikuan 3 produkte, në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuara si më poshtë:

						në mijë lekë
MINISTRIA MBROJTJES						Kodi : 17
Programi: Arsimim Ushtarak						Titulli: O9430
Kodi i Prod.	Emri i Produktit	Ins.Buxh.	VITI 2013			
			(3) Buxheti i Rishikuar	(4) Fakti	Mbetja (1-2)	% Realizimit
1	Personel në Shtabin e KDS (5001.5561,5570,5566)	Rep.Usht.Nr.5001 Tirane - KDS	763,100	750,703	12,397	98
3	Bashkëshortë ushtarakësh që përfitojnë pagesë papunësie	Rep.Usht.Nr.5570 Vl.- Br.S.	14,122	14,031	91	99
4	Sistemime infrastrukture në KDS		85,000	78,961	6,039	93
TOTALI			862,222	843,695	18,527	98

Edhe në programin "Arsimimi Ushtarak", shpenzime personeli, shpenzime korrente, produktet janë realizuar në masën 98%.

- Shpenzimet për personelin janë realizuar në masën 99%.
- Realizimi i detyrimeve për vitin 2013 për bashkëshortet e ushtarakëve që përfitojnë pagesë papunësie është në masën 99%.
- Sistemimi infrastrukturor është kryer procedura e prokurimit dhe është lidhur kontrata me kontraktorin. Realizimi i kontratës arrin në masën 91%.

4. Programi “Mbështetje shëndetësore”.

Shpenzimet faktike për vitin 2013 në këtë program, që përfaqëson rreth 0.4 % të totalit shpenzimeve faktike të Ministrisë, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor, sipas ligjit të buxhetit, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korrente 95.2 %
- Shpenzimet kapitale 0.0 %
- **Gjithsej 95.2 %**

Në këtë program janë parashikuar 2 produkte për këtë vit. Ecuria e produkteve jepet nga tabela:

MINISTRIA MBROJTJES				Kodi : 17		
Programi: Mbështetja Shëndetësore				Titulli: O7340		
Kodi i Prod.	Emri i Produktit	Ins.Buxh.	VITI 2013			
			(1) Buxheti i Rishikuar	(2) Fakti	Mbetja (1-2)	% Realizimit
1	Personel SUQU	REP.6030	88,050	59,984	28,066	95
2	Bashkëshortë ushtar. që përfitojnë pagesë papunësie		1,200	11,919	632	81
TOTALI			89,250	85,002	4,248	95

Janë raportuar të dhëna mbi sasitë e planifikuara dhe të realizuara për secilin nga produktet e përfshira në programin “Mbështetja Shëndetësore” shpenzime personeli 96%, transfertat 81%. Produktet janë realizuar në masën 95%, për vitin buxhetor 2013.

5. Programi “Mbështetja e luftimit”

Shpenzimet faktike për vitin 2013 në këtë program, që përfaqëson rreth 22.1% të totalit shpenzimeve faktike të Ministrisë, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor, sipas ligjit të buxhetit, rezultojnë si më poshtë:

- Shpenzimet korrente 99.5%
- Shpenzimet kapitale 100%
- **Gjithsej 99.5%**

Në këtë program për 12 - mujorin e vitit 2013, u parashikuan 7 produkte; të dhënat mbi sasitë e planifikuara dhe të realizuara për secilin nga produktet e përfshira në këtë program janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

MINISTRIA MBROJTJES				Kodi: 17		
Programi: Mbështetja e Luftimit				Titulli: O2150		
Kodi i Prod.	Emri i Produktit	Ins.Buxh.	VITI 2013			
			(1) Buxheti i Rishikuar	(2) Fakti	Mbetja (1-2)	% Realizimit
1	Personel Brigadën Logjistike (4001)	Rep. Usht. 4001.	3,281,545	3,272,141	9,404	100
3	Personel në Qendrën e Personelit		93,350	88,410	4,940	95
4	Personel ne Policinë Ushtarake	Rep. Usht. 6620	428,270	428,268	2	100
5	Ushtarakë të transferuar që përfitojnë pagesë papunësie (bashkëshorte)		299,094	292,265	6,829	98
6	Ushtarakë në lirim që trajtohen me pagesë kalimtare	Rep. Usht. 6670	20,000	19,900	100	100
7	Rikonstruksion QKU, ESKU, Tiranë	Rep. Usht. 6660	107,000	107,000	-	100
TOTALI			4,229,259	4,207,984	21,275	99

Janë raportuar të dhëna mbi sasitë e planifikuara dhe të realizuara për secilin nga produktet e përfshira në programin Mbështetja Luftimit ku realizimi është për pagat 100%, mallra dhe shërbime 100%, transfertat 98%.

- Për Repartin Ushtarak Nr.6660, Rikonstruksion QKU, ESKU është kontratë në vazhdim nga viti 2011.

6. Programi “ Mbështetje Sociale për ushtarakët”

Shpenzimet faktike për 12-Mujorin e vitit 2013 në këtë program, që përfaqëson rreth 23.1 % të totalit të shpenzimeve faktike të Ministrisë, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor, sipas ligjit të buxhetit, rezulton si më poshtë:

- Shpenzime korrente 100 %
- **Gjithsej 100 %**

Në këtë program shpenzime personeli, shpenzime korrente, produktet janë realizuar në masën 100 %.

MINISTRIA MBROJTJES				Kodi : 17	
Programi: Mbështetje sociale për ushtarakët I.S.SH				Titulli: 10270	
Kodi i Prod.	Emri i Produktit	VITI 2013			
		(1) Buxheti i Rishikuar	(2) Fakti	Mbetja (1-2)	% Realizimit
A	Ish ushtarakë që trajtohen me pensione suplementare	4,550,000	4,550,000	-	100
TOTALI		4,550,000	4,550,000	-	100

7. Programi “Bashkëpunim civilo-ushtarak”

Shpenzimet faktike për 12-mujorin e vitit 2013 në këtë program, që përfaqëson rreth 3.1% të totalit shpenzimeve faktike të Ministrisë, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor, sipas ligjit të buxhetit, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 97.9%
- Shpenzimet kapitale 0.0%
- **Gjithsej 97.9 %**

Në këtë program janë parashikuar 2 produkte për këtë vit, ecuria e produkteve jepet nga tabela si më poshtë :

MINISTRIA MBROJTJES				Kodi : 17		
Programi: Bashkëpunimi Civilo-Ushtarake				Titulli: O2280		
Kodi i Prod.	Emri i Produktit	Ins.Buxh.	VITI 2013			
			(3) Buxheti i Rishikuar	(4) Fakti	Mbetja (1-2)	% Realizimi t
1	Personel i Brigadës Mbështetëse Rajonale	Rep.Usht.Nr. 7001	563,140	552,805	10,335	98
2	Ushtarakë të transferuar që përfitojnë pagesë papunësie (bashkëshorte)		11,773	10,295	1478	87
TOTALI			563,140	563,100	10,335	95

Janë raportuar të dhëna mbi sasi të planifikuara dhe të realizuara për secilin nga produktet e përfshira në këtë program, "Bashkëpunim civilo - ushtarak", Siç shihet nga tabela këto produkte janë realizuar në masën 98% shpenzimet për personel dhe në masën 98% ato për transferta bashkëshorte në masën 87%.